



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1429/11 Prot.

Tiranë, më 28.05 2024

V E N D I M

Nr. 44 dt. 28.05 2024

**“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE PROFILIZUESE DERI NË MASËN 20% TË
PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR NË “SHKENCAT E
REHABILITMIT”, TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË REHABILITMIT”**

Mbështetur në nenin 3 pika 2 gërma b, 35, 37, 38 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Udhëzimin e MASR nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7 pika 2 gërma b, nenin 19, nenin 20 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 48, 52 dhe 53 të Rregullores së UST-së, shkresës nr. 1198 prot. datë 25.04.2024 “Propozim për ndryshime profilizuese deri në masën 20% të programit të ciklit të parë të studimit Bachelor në Shkencat e Rehabilitimit”, të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit, pas propozimit nga Rektorati, Senati Akademik në mbledhjen e datës 28.05.2024,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve profilizuese në masën 17,2 %, në programin e ciklit të parë të studimit “Bachelor në “Shkencat e Rehabilitimit”, ofruar nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit (Plani Mësimor bashkëlidhur).
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit, Departamenti i Shkencave Biomjekësore dhe Humane, si dhe i përcillet Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Agron KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE BIOMJEKËSORE DHE HUMANE

Nr. 118/6 Prot.

Tiranë, më 21/05 /2024

Lënda: Arsyeja e ndryshimeve të bëra në masën 17.2 % në planin mësimor të ciklit të parë të studimit Bachelor në “Shkenca të Rehabilitimit” në FSHR.

DEKANIT TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE TË REHABILITIMIT

PROF. DR. ROBERT ÇINA

Bazuar në sugjerimet e Rektoratit në mbledhjen e bërë në datën 20.05.2024, më poshtë gjeni argumentimin pse lindi nevoja për ndryshime në Programin e studimit “Shkenca të Rehabilitimit” të ciklit Bachelor.

Shëndeti është aspekti kryesor i shoqërisë moderne, me burime në rritje të dedikuara për përparimin mjekësor dhe sistemet e shëndetit publik, që në fakt kanë qenë shumë të suksesshme në arritjen e niveleve të avancuara të rehabilitimit dhe mirëqënien për popullatën në përgjithësi.

Propozimi dhe ndërhyrja në ndryshimin e kurrikulës vjen si nevojë e zhvillimeve të reja në fushën e shëndetësisë, si dhe për të përshtatur programin me nevojat aktuale, zhvillimin e teknologjisë dhe metodat më efektive rehabilituese. U pa e nevojshme të përmirësohen dhe të shtohen materialet më të fundit për të trajtuar lëndët e ndryshuara.

Ne kuadër të ndërkombëtarizimit të kurrikulës, të procesit të mësimdhënies dhe të nxënit po bëjmë përafrimin e programit për të pasur mundësinë e diplomave të përbashkëta.

Kurrikula dhe rezultatet e synuara të të nxënit ofrojnë një balancë të mirë midis teorisë dhe praktikës duke reflektuar standarte të edukimit në nivel evropian, duke i lejuar studentët të plotësojnë nevojat e tregut të punës në vendin e tyre, si dhe gjithashtu të kualifikohen për një kontekst shumë më të gjerë social dhe pune në të gjithë Europën.

Bashkëlidhur kësaj shkrese gjendet tabela me lëndet /modulet/ kreditet e planit mësimor ekzistuese dhe ato të ndryshuara, gjithashtu edhe argumentimin për cdo ndryshim të bërë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTUESI I DEPARTAMENTIT

Prof. Asc. Dr. Oltiana-PETRI

PROGRAMI MESIMOR I CIKLIT TE STUDIMIT "BACHELOR" NE "SHKENCA TE REHABILITIMIT" NE FSHR					
KURSI I PARE					
SI ESHTË PROGRAMI EKZISTUES		SI PRITET TË NDRYSHOHET PROGRAMI			PSE ESHTË NDRYSHUAR
Lënda/ Moduli	Ects Ishte	Lënda/ Moduli	Ects Ndryshim	Ndryshimi	
2. BIOLOGJI / BIOKIMI	8	2. BIOLOGJI / BIOKIMI	6	2 kredite	
• Biologji e Përgjithshme dhe e Aplikuar	3	• Biologji e Përgjithshme dhe e Aplikuar	3		
• Biokimi & Biokimi Klinike	3	• Biokimi & Biokimi Klinike	2		U hoq 1 kredit. Nga 3 kredite u ndryshua në 2 kredite
• Gjenetikë Mjekësore	2	• Gjenetikë Mjekësore	1		U hoq 1 kredit. Nga 2 kredite u ndryshua ne 1 kredit
4. MJEKËSI FIZIKE, DIAGNOSTIKIM	15	4. MJEKËSI FIZIKE, DIAGNOSTIKIM	17	2 kredite	Lenda MJEKËSI FIZIKE, DIAGNOSTIKIM nga 15 kredite u be 17 kredite
• Fiziologjia e Njeriut	4	• Fiziologjia e Njeriut	4		
• Fiziologji e Ushtrimit	3	• Fiziologji e Ushtrimit	3		
• Kontrolli Mjekësor	3	• Kontrolli Mjekësor dhe Fizioterapeuti	5		
• Kineziologji	3	• Kineziologji	5		Moduli Kineziologji nga 3 ect u be 5 ect U shtuan 2 kreditet e moduleve Biologji e Përgjithshme dhe e Aplikuar dhe Biokimi & Biokimi Klinike. Ky ndryshim i jep më shumë rëndësi modulit profesional për studentët e degës së Shkencave të Rehabilitimit
• Infermieristika	2	• Infermieristika	moduli hiqet		Moduli Infermieristika u hoq nga programi dhe kreditet e këtij moduli u shtuan modulit Kontrolli mjekësor duke I dhënë më shumë rëndësi moduleve me bazë profesionale për fushën e rehabilitimit, gjithashtu ky modul nuk perfshihej ne asnje program Nderkombetar te Fizioterapise.
5. GJUHË E HUAJ	6	5. GJUHË E HUAJ	6		
• Gjuhë Angleze	2	• Gjuhë Angleze	4	2 kredite	U shtuan 2 kreditet e modulit Linguistikë
• Gjuhë Latine	2	• Gjuhë Latine	2		
• Linguistikë	2	• Linguistikë	moduli hiqet		Moduli u hoq nga programi dhe kreditet u shtuan modulit Gjuhë Angleze , gjithashtu ky modul nuk perfshihej ne asnje program nderkombetar te Fizioterapise.
6. SHKENCA HUMANE & SOCIALE	7	6. SHKENCA HUMANE & SOCIALE	7		
• Psikologjia e Njeriut	3	• Psikologjia e pergjithshme dhe klinike	3		Ndryshim dhe përmirësim emërtimit
• Sociologji	2	• Sociologji	2		
• Bioetike	2	• Bioetike & Legjislacion Mjekësor	2		Ndryshim dhe përmirësim emërtimit

GRUPI I PUNES

Prof. Dr. Robert ÇINAJ

Prof. Asc. Dr. Oltiana PËTRIT

Prof. Asc. Dr. Genti PANO

Prof. Asc. Dr. Vjollca SHPATA

Dr. Aisel OSEKLI

Dr. Klejda TANI

Msc. Fregen DHAMAJ

Msc. Andromeda LALAJ

PROGRAMI I STUDIMIT "BACHELOR" NË "SHKENCA TE REHABILITIMIT" NË FSHR					
KURSI I DYTË					
SI ËSHTË PROGRAMI EKZISTUS		SI PRIETET TË NDRYSHOHET PROGRAMI			PSE ËSHTË NDRYSHUAR
Lënda/ Modulli	Ects Ishte	Lënda/ Modulli	Ects Ndryshim	Ndryshimi	
1. MORFOLOGJI APLIKUAR	6 KREDITE Lenda hiqet	1. METODA BAZE TE VLERESIMIT DHE TRAJTIMIT NE FIZIOTERAPI	8	8 kredite	Lënda MORFOLOGJI APLIKUAR hiqet totalisht me modulet brënda saj. Krijohet Lënda e re METODA BAZE TE VLERESIMIT DHE TRAJTIMIT NE FIZIOTERAPI e cila përban një program të detajuar mbi mënyrën e ekzaminimit dhe trajtimit në fushën e fizioterapisë, lëndë me baza të rëndësishme në formimin profesional të studentëve të degës së Shkencave të Rehabilitimit
3. PATOLOGJI SPECIFIKE	12	3. PATOLOGJI SPECIFIKE	12		
• Geriatri	3	• Geriatri	3		
• Reumatologji	3	• Reumatologji	3		
• Ortopedi	3	• Ortopedi	3		
• Traumatologji Sportive	3	• Traumatologji	3		Ndryshim dhe përmirësim emërimit
4. FORMIM NDERDISIPLINOR	6	4. FORMIM NDERDISIPLINOR	4	2 kredite	
• Farmakologji	2	• Farmakologji	2		
		• Anatomi Imazherike	2		Moduli Anatomi Imazherike spostohet në lëndët Formim Nderdisiplinor duke qënë që përshatet me shumë në qellimin e kësaj lënde për studentët e degës së Shkencave të Rehabilitimit
• Psikologji Zhvillimi	2	• Psikologji Zhvillimi	moduli hiqet		Ky modul u hoq pasi nuk përfshihet në asnjë program Nderkombetar te Fizioterapise.
• Psikopatologji	2	• Psikopatologji	moduli hiqet		Ky modul u hoq pasi nuk përfshihet në asnjë program Nderkombetar te Fizioterapise.
6. REHABILITIM I PERGJITHSHEM	10	6. REHABILITIM I PERGJITHSHEM	10		
• Rehabilitim I Aparatit Lokomotor	4	• Rehabilitim I Aparatit Lokomotor	4		
• Rehabilitim ne Geriatri	3	• Rehabilitim ne Geriatri	3		
• Rehabilitim Logopedik	3 moduli hiqet	• Elektroterapia	3	3 kredite	Moduli Rehabilitim Logopedik u hoq nga programi i lendes dhe ne vend te saj u vendos Moduli Elektroterapia, i cili u spostua nga viti trete ne vitin e dyte pa u ndryshuar kreditet e modulit. Kjo sepse informacionet e këtij moduli duhen marr në vitin e dytë akademik dhe jo në vitin e tretë akademik.

GRUPI I PUNES

Prof. Dr. Robert CINA

Prof. Asc. Dr. Oltiana PETRI

Prof. Asc. Dr. Genti PANO

Prof. Asc. Dr. Vjollca SHPATA

Dr. Aisel OSEKU

Dr. Klejda TANI

Msc. Fregen DHAMAJ

Msc. Andromeda LALAJ

PROGRAMI STUDIMIT "BACHELOR" NË "SHKENCA TE REHABILITIMIT" NË FSHR

KURSI TRETË

SI ËSHTË PROGRAMI EKZISTUES		SI PRITET TË NDRYSHOHET PROGRAMI			PSE ËSHTE NDRYSHUAR
Lënda/ Moduli	Kredite	Lënda/ Modulli	Kredite	Ndryshimi	
1. PATOLOGJI SPECIALITETESH	11	1. PATOLOGJI SPECIALITETESH	11		
• Neurologji	4	• Neurologji	4		
• Pediatri	3	• Pediatri	3		
• Shendet Publik dhe Higjena sportive	4	• Shendet Publik dhe Metodologjia e kerkimit shkencor	4		Ndryshim dhe përmirësim emërtimit
2. PROSTETIKË	6 KREDITE Lenda hiqet	2. FORMIM NDERDISIPLINOR 2	6	6 kredite	Lënda Prostetikë është zëvendësuar me lëndë "Formim Ndërdisciplinor 2" dhe modulet e reja brënda saj. Ky ndryshim është i rëndësishëm për arsy sepse ne programin fillestar këto informacione mungojnë dhe janë module bazë për studentët e Shkencave të Rehabilitimit
• Foniatri	2	• Rehabilitim ORL dhe Maksilofacial	1.5		
• Ortoproestetik	2	• Patologjite Kirurgjikale dhe Onkologjike	3		
• Pajisje Rehabilitimi	2	• Rehabilitim Onkologjik	1.5		
3. MJEKESI FIZIKE DHE REHABILITIM	13	3. MJEKESI FIZIKE DHE REHABILITIM	13		
• Termo-hidro-klima Terapia	2	• Termo-hidro-klima Terapia	2		
• Elektro terapia	3 kredite moduli hiqet dhe vendoset ne vitin e dyte	• Terapi Manuale	3	3 kredite	Moduli Elektro terapia u hoq dhe u vendos në vitin e dytë akademik. Moduli Terapi Manuale u vendos në vënd të modulit Elektroterapia, sepse është një modul me informacione bazë profesionale të rëndësishme për tudentët e Shkencave të Rehabilitimit
• Masazh Sportiv	2	• Masazh Sportiv	2		
• Teknika te Trajtitimit në Fizioterapi	4	• Teknika te Trajtitimit në Fizioterapi	4		
• Ergoterapi	2	• Terapi Okupacionale	2		Ndryshim dhe përmirësim emërtimit sipas kurrikulave nderkombetare
4. LENDE ME ZGJEDHJE	3	4. LENDE ME ZGJEDHJE	3		
• Aqwaterapi	3	• Aqwaterapi	3		
• Edukim Fizik - Fitnes	3	• Edukim Fizik - Fitnes	3		
• Kinezioterapi	3 kredite moduli hiqet	• Telerehabilitim	3	3 kredite	Moduli me zgjedhje Kinezioterapi është ndryshuar me modulën Telerehabilitim sipas sugjerimit projektit Erasmus+ qe jemi partner dhe ndërkombëtarizimit të programit Bachelor.

GRUPI I PUNES

Prof. Dr. Robert ÇINA

Prof. Asc. Dr. Oltiana PETRI

Prof. Asc. Dr. Genti PANO

Prof. Asc. Dr. Vjollca SHPATA

Dr. Aisel OSEKU

Dr. Klejda TANI

Msc. Fregen DHAMAJ

Msc. Andromeda LALAJ